



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 323/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkanlive të Kosovës (PDAK), dega në Ferizaj për shkak të zhvillimit të fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkanlive për Integrim (PAI), dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

Me datën 23.10.2013, subjekti politik PAI, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se me datë 20.10.2013 në Ferizaj subjekti politik PDAK-ja, ka mbajtur fushatë zgjedhore në të cilën ishin pjesëmarrës qindra fëmijë të pranishëm. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se me ligj fëmijët nuk mund të jenë pjesë e fushatave dhe kësaj ankesë i janë bashkangjitur si provë disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDAK në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013.

PZAP-i, e pranoi përgjigjen e kërkuar nga PDAK-ja sipas afatit të caktuar, dhe në këtë përgjigje ceket se pretendimet e PAI-së janë shpifje pasi që me datë 20.10.2013 në fushatën zgjedhore të PDAK-së nuk ka pasur fëmijë të pranishëm. PDAK-ja këtë e bazon duke pretenduar se në video incizimet e TV Tema mund të shihet që nuk ka pasur fëmijë të pranishëm, ku me këtë rast është bashkangjitur një foto nga fushata zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Sipas ankesës së parashtruar në PZAP, pala ankuese pretendon se PDAK-ja ka organizuar fushatë zgjedhore në Ferizaj ku qindra fëmijë ishin të pranishëm.

PZAP-i gjeti se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është objektive, me të cilat vihet në dyshim së është kryer një veprim i ndaluar për arsye se fotografia e ofruar si provë nga shihet se është organizuar mbajtja e fushatës nga radhët e PDAK-së, mirëpo pjesëmarrja e fëmijëve në fushatë zgjedhore nuk është e ndaluar sipas dispozitave të LZP-së. PZAP-i konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i paqartë për tu administruar si provë relevante

nga fotografia e paraqitur si dëshmi bindëse. Përveç asaj që u tha më lartë, në legjislacionin për zgjedhjet në Kosovë nuk ekziston ndonjë ndalesë apo sanksion i paraparë me ligj për pjesëmarrjen e fëmijëve në fushatë zgjedhore. Andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në Nenin 118, par.1 të LZP-së. PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 323/2013 më datën 25.10.2013



#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*